

Tirane 25 /11/2017

**Lenda: Kerkese per nderprerje te procedurave licensuese koncesionare ne vazhdim dhe te planifikuara, si edhe moratorium per ndertimin e HEC-ve ne shtratin kryesor dhe rrjedhjet anesore te Lumin Vjosa.**

Drejtuar

**Z. Edi Rama**

**Kryeminister i Shqiperise**

**Z. Damian Gjiknuri**

**Minister i Infrastrukturës dhe Energjisë**

Te nderuar Zoterinj,

Ne emer te Konfindustrise/Konfederata e Industrive te Shqiperise paraqes kerkesen per nderprerje te procedurave licensuese koncesionare ne vazhdim dhe te planifikuara, si edhe moratorium per ndertimin e HEC-ve ne shtratin kryesor dhe rrjedhjet anesore te Lumin Vjosa. Moratoriumi te jete ne fuqi deri ne nje moment te dyte, kur te jene perbatitur nga institucionet shteterore projektet e reja te bershmerise/fisibilitetit ekonomike-financiare dhe mjesidore sipas standardeve me te larta te BE.

Arsyet e kerkeses se mesiperme i paraqesim si me poshte:

- 1- Projektet e leverdishmerise ekonomike-financiare per te mbeshtetur vazhdimin e ndertimit te HEC ne shtratin kryesor dhe rrjedhjet anesore te Lumin Vjosa, duhet te ribehen nga institucionet shteterore:

Studimet e bershmerise/fisibilitetit ekonomik te ndertimit te HEC duhet te kene parasysh ndryshimet rrenjesore te tregut te energjise elektrike pas krizes globale. Renia e forte dhe shtrirja ne kohe e cmimeve relativisht te ulta te energjise elektrike ne tregjet nderkombetare, investimet e rendesishme ne linjat e interkonjekzionit dhe trasmisionit ne Shqiperi si dhe kthimi ne komerciale e teknologjive te reja te prodhimit te energjise te riperteritshme si dielli, era, etj., e ben te detyrueshme kerkesen e mesiperme. Studimet e derisotme jane mbi 10 vjecare dhe jane te paplota per te dhene nje rezultat te besueshem financiar, qe mund te japi nje perfundim te besueshem perllogaritje per te vleresuar

perfitimin publik nga ndertimi i HEC ne lumin Vjosa.Gjithashtu, studimet mjedisore duhet te kryhen drejt paraqitjes se disa alternativave zhvillimi te qendrueshem ekonomik te zones te ndryshme dhe/ose te gershetuar si psh turizmi, agroturizmi, bujqesia, industria ushqimore, mjekesore/rekracion, sherbime, etj. plotesisht te mundshme ne rastin e Rajonit te Lumin Vjosa.

- Studimet mjedisore duhet te kryhen sipas standardeve me te larta nderkombetare te BE, qe mbeshteten ne percaktimin e sakte te raportit kosto-perfitim finanziar ne afatgjate te pasojave ne mjesdis. Ne cdo rast vleresimi mjesdisor duhet te perllogaritet ne tregues te plote dhe te matshem financiare te prekshem/materiale dhe te paprekshem/jomateriale ne afatgjate ne reportin kosto-perfitim te ndertimit te cilido variant te HEC dhe njekohesisht krahesimisht modeleve alternative te zhvillimit te qendrueshem ekonomik. Sot legjislacioni shqiptar ne fuqi eshte i paplote per sa me siper. P.sh asnje studim mjesdisor nuk llogarit humbjet financiare si pasoje e mundesise se uljes se numrit te turisteve, qe shkakton humbja e markes si "lumi i vetem i eger ne Europe", qe Vjosa gezon sot ne te gjitha manualet turistike, nese vendoset per ndertim te HEC te Kalivacit etj. ne shtratin kryesor te saj.

- Duhet te kryhet permiresimi ligjor, qe ne politiken koncesionare tashme te hiqet dore nga propozimet e "pakerkuara" nga sektori privat, te pakten ne sektoret me te rendesishem dhe te ndjeshem per ndikimin ne mjesdis. Duhet te jene institucionet perkatese shteterore, qe duhet te marrin persiper ndertimin e projekteve baze te leverdise ekonomike dhe projektet mjesdisore, qe mendohet te zhvillohen me menyra te ndryshme financimi.

- 2- Lugina e Vjoses perben nje pasuri te madhe kombetare dhe nga te paktat qe kane mbetur. Interesi per ruajtjen e lumen Vjosa te paprekur nga ndertimet e HEC dhe parqeve industriale eshte i madh edhe nga institucionet te rendeishme europiane dhe me gjere, qe e vleresojne si pasuri te gjithe Europe. Potencialisht kjo do te thote, se eshte plotesisht e mundur terheqja e financimeve nderkombetare ne projekte per zhvillimin e qendrueshem te rajonit te lumen Vjosa ne te mire te qytetareve dhe ekonomise kombetare ne afatgjate, te ndryshme nga politikat e ndertimit te HEC. Ne kendveshtrimin tone pjekuria e institacioneve shqiptare ne plotesimin e standardeve mjesdisore nderkombetare dhe dhenia e zgjidhjeve te qendrueshme ekonomike ne afatgjate, mund gjithashtu te jete nje nga lejekalimit te Shqiperise per procesin e integrimit ne BE.
- 3- Moratoriumi per procedurat ligjore ne vazhdim ne pergjithesi ne vend dhe ne vecanti per HEC e Kalivacit eshte i domosdoshem edhe per te parandaluar nje perkeqesim te pozicionit te shtetit shqiptar ne gjykata nderkombetare te arbitrazhit, kur dihet se ceshtja perkatese eshte ne vazhdim. Penalitetet financiare do te jene ne shifra marramendese, nese Shqiperia humbet ceshtjen ne arbittrash per ceshtjen e HEC te Kalivacit.

- 4- Moratoriumi per ndetimet ne HEC ne lumin Vjosa duhet te sherbeje per permiresimet ligjore ekonomike dhe mjedisore te domosdoshme per te gjitha politikat zhvilluese te shtetit shqiptar ne gjithe shtrirjen e tij tokesore dhe gjithe fushat e ekonomise dhe infrastrukture. Eshte e papranueshme, qe investimet te drejtohen ne projekte qe rrenojnë dhe shkaterrojnë pergjithmone zonat e mbrojtura, lumenjte dhe kane pasoja te ndjeshme ne mjeshtësi.

Konfindustria, ne paraqitjen e kerkeseve se mesiperme, ka terhqe me mendimin e bizneseve te rajonit te Lumit Vjosa dhe me gjere. Gjithashtu, Konfindustria ka organizuar Forumin Nderkombetar te Zhvillimit te Lugines se Lumit Vjosa, Permet-2018 , me pjesemarrjen e perfaqesuesve te bashkive nga malet e Pindit-Greqi deri ne Detin Adriatik, perfaqesuesve te rrjetave mjedisore te vendit dhe nderkombetare, botes universitare, etj. mendimi i pergjithshem i pjesemarresve ishte ndertimi i modeleve te arsyetuar ekonomike per zhvillimin e qendrueshem te rajonit dhe jo vetem perqendrimi ne politikat e ndertimit te HEC.

Te nderuar Zoterinj,

Ne sot nuk jemi ne gjendje te japim një perqigje te qarte per perfitimin ekonomik ne interes publik ne afatgjate te menyrave te zhvillimit te qendrueshem ne afatgjate te Rajonit te Lumit Vjosa. Qartesisht te perkthyera ne vlera te qarta financiare ne nuk te dime, -nese duhet te vazhdojme ne politika te ndertimit te HEC,- nese eshte e mundur te ndertohen modele te zhvillimit pa HEC ose - duhet një nderthurje e modeleve te mesiperme. Gjithashtu, ne sot per arsyet ligjore dhe institucionale jemi te papergatitur per te organizuar gara tenderuese, qe mbeshteten ne standartet me te mira nderkombetare mjedisore dhe ekonomike, nga te cilat ne mund te perzgjedhim menyrën me te mire te zhvillimit te qendrueshem te Lugines se Vjosës, qe mbron interesin publik ne afatgjate.

Arsyet e mesiperme besoj, se jane te mjaftueshme per te kerkuar nderprerjen e procedurave licensuese per ndertimin e HEC te Kalivacit ne Lumin e Vjosës dhe moratorium me afat kohor te mjaftueshem per te kryer permiresimet ligjore sipas standardeve te BE dhe perqatitjeve te projekteve te reja ekonomike dhe mjedisore, qe duhet te mbeshteten ne standartet ne fjale. Nese sot eshte e qarte se nuk jemi te sigurt, qe mund te bejme dicka te mire do te ishte e pafalshme, qe te bejme gabime te medha,

Me respect

**Gjergj Buxhuku**



**Administrator I Pergjithshem**